

EPOKA ERE

E përditshme e pavarur
Viti XXIII, nr. 6945
E hënë, 17 korrik 2023
Çmimi 0.40

Nuk ka pritur të gjata në pikëkalimet kufitare



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

KOSOVA BLEN DRONË "BAYRAKTAR"



Ushtria jonë çdo ditë e më shumë po konsolidohet jo vetëm në aspektin e kuadrove profesionale, por edhe me

pajisje më moderne ushtarake. Dronët "Bayraktar TB-2", të cilët u përruan nga kryeministri Albin Kurti, ministri Armend

Mehaj dhe komandanti i FSK-së, Bashkim Jashari, janë vetëm disa nga pajisjet e blera për ta forcuar ushtrinë tonë

AKTUALE



QEVERIA GJERMANE KRITIKON NJË RREGULLORE TË BE-së PËR AZILIN

MBI 700 PICKIME TË RRJORAVE NË MALISHEVË, TRE PERSONA JANË DËRGUAR NË OKUK

PËRFUNDON UNIVERSITETI VEROR I PRISHTINËS

EKONOMI



KURTI: PËRFITIMET PËR VETERANËT NUK NËNKUPTOJNË PAGË

KOSOVA AS SJIVJET NUK PRITET TA SIGUROJË BUKËN

SPORT




KOSOVA E FITON EDHE MIQËSORËN E DYTË NDAJ LIHTENSHTAJNIT

PSE ËSHTË KJO VERË KAQ E NXEHTË?



VITIN E KALUAR MBI DY MIJË ÇIFTE U SHKURORËZUAN, PRIZRËNI KOMUNA ME NUMRIN MË TË MADH TË NNDARJEVE



RENOVA
PUTZ
Kryesqiptar
Zhvillim - Tërvet
Qendër - Përtëritje
E-mail: resovabiznesi.net.mk

PRINCESHA
NDERTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princessa-ki.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVË
MITROVICË
STYROKOL - BUNJAKOL - ÇUROFASADË
044/256-051
044/367-061
028/532-617

Kolegji BIZNESI
www.kolegji.biznesi.com
info@kolegji.biznesi.com
030 500 870 | 045 500 870
044 500 870 | 049 500 870

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP BILA
PRVA SIGURNOSTNA AGENCIJA
PRAHA
Prishtinë, Prizren, Mitrovicë
Tirana, Shkup, Ohrid, Gostivar, Tërvet
Fax: +381 30103 046 507 514 | +381 30103 246 302
E-mail: info@sigma-ki.net | www.sigma-ki.net

INFINITY
Digital Agency
Endrit Shaqiri
+38344685122
Internet Website,
Marketing...

Qeveria gjermane kritikon një rregullore të BE-së për azilin

BREZIN, 16 KORRIK - Berliri e ka kritikuar një rregullore që ua mundëson shteteve të mbingarkuara të BE-së që të kenë afate më të gjata për t'i regjistruar aplikimet për azil në kufijtë e jashtëm si dhe mundësinë e uljes së standardeve për akomodim dhe kujdes. Por, Spanja, në anën tjetër, e cila aktualisht udhëheq presidencën e BE-së, dëshiron të arrihet një marrëveshje në këtë temë deri në fund të muajit. "Rregulloria e propozuar është ende subjekt i

rishikimit brenda qeverisë federale", ka thënë një zëdhënës i Ministrisë së Brendshme të Gjermanisë. Më 8 qershor ministrat e Brendshëm të BE-së kanë votuar për ta reformuar sistemin e azilit. Sipas planeve, aplikimet e migrantëve për azil, të cilët janë nga vendet me një normë njoheje prej më pak se 20 për qind, do të shqyrtohen në kufijtë e jashtëm të BE-së brenda 12 javëve.

Gjatë kësaj kohe ata që kërkojnë mbrojtje do të

detyrohet të qëndrojnë vetëm nëpër qendrat e azilit. Ata që nuk kanë mundësi për të fituar azil, do të kthehen menjëherë mbrapsht. Përveç kësaj, rregulloria parasheh që ata persona që kërkojnë mbrojtje në situata krize, duhet të qëndrojnë më shumë se 12 javë nëpër qendra të pranimit, afër kufijve.

Situatë krize konsiderohet kur një shtet tjetër tenton ta përdorë krizën me refugjatë për t'i shtyrë përpara interesat e veta, siç ka qenë kriza në kufirin



bjelloruso-polak. Përgjatë negociatave, ministrija e Brendshme gjermane, Nancy

Fesser, ka argumentuar se për familjet me fëmijë nuk duhet të vlejë këto rregulla në kufi.

Yellen: Mbështetja për Ukrainën, rruga më e mirë për t'i ndihmuar ekonomisë globale


WASHINGTON, 16 KORRIK - Dytishimi i mbështetjes për Ukrainën është mënyra më e mirë për t'i ndihmuar ekonomisë globale, ka thënë sekretarja amerikane e Thesarit, Jane Yellen të dielën. Duke folur në margjina të samitit të ministrave të Financave të 20 vendeve më industrializuara në botë (G20), që po mbahet në Indi, Yellen ka thënë se "prioriteti kyç" është që "të dyfishohet mbështetja për Ukrainën" teksa mbrohet kundër pushtimit rus. Pas vizitës që ka realizuar në Kiev, në shkurt të këtij viti, Yellen ka thënë se e ka parë nga afër

diferencën që po e bën ndihma për Ukrainën, si për civilët, ashtu edhe për ushtrinë ukrainase. "Dhënia fund e kësaj lufte është thelbësore, dhe është gjëja më e mirë që mund të bëjmë për ekonominë globale".

Lufta e Rusisë në Ukrainë e ka tronditur gjithë botën, pas një rritur çmimet e ushqimit dhe naftës.

Të dyja vendet janë ndër eksportuesit më të mëdha të grurit në botë.

Një marrëveshje, që i ka mundësuar Ukrainës ta eksportojë grurin e saj përmes Detit të Zi, skadon të hënën, përveç nëse Rusia pajtohet për



ta zgjatur atë.

Të mërkurën liderët e shtatë vendeve më të industrializuara (G7) janë zotuar se do ta

mbështesin Ukrainën aq sa të ketë nevojë. Plani i G7-s parasheh një kornizë, sipas së cilës, shtetet

individuale do të nënshkruajnë marrëveshje bilaterale me Kievin për t'i konkretizuar llojet e armëve që do të dërgohen në Ukrainë.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt 2022.

Presidenti rus Vladimir Putin e quan luftën "operacion special ushtarak" që ta çmilitarizuar Ukrainën.

Perëndim është përgjigjur ndaj Rusisë, duke goditur ekonominë e këtij shteti me sanksione të ashpra.

Si pasojë e luftës kanë vdekur mijëra persona dhe miliona të tjerë janë zhvendosur nga shtetëpë të tyre.

Vdes këngëtarja dhe aktorja Jane Birkin



PARIS, 16 KORRIK - Jane Birkin, këngëtarja dhe aktorja britanike, e cila është bërë ikonë e modës në Francë, ka vdekur në moshën 76-vjeçare. Birkin ka vuajtur së fundi nga problemet shëndetësore, prandaj edhe i pati anuluar koncertet. Shkaku i saktë i vdekjes së saj nuk është dhënë. Birkin i ka prekur majat e suksesit ndërkohë që ka kaluar nëpër një marrëdhënie turbulente me këngëtarin dhe

tekstshkruarëin Serge Gainsbourg.

Ajo është njohur për theksin e saj të veçantë francez. Shumë e kanë përkrahur atë si vajzën ikonë të viteve 1970. Në vitin 1984 Hermes e ka dizajnuar një çantë me emrin e saj, dhe prej atëherë ajo konsiderohet simbol i kompanisë.

Reagimet për vdekjen e Birkin kanë qenë të shpejta.

Presidenti francez Emmanuel Macron e ka quajtur

Birkin "artiste të kompletuar", e cila "ka kënduar fjalët më të bukura të gjuhës sonë". "E paimagjinueshme të jetojmë një botë pa dritën tënde në të", ka thënë këngëtarja Etienne Daho, një prej mikëve të saj të ngushta.

Kryeministria franceze Elisabeth Borne e ka përkrahur atë si "ikonë të paharrueshme, me zë unik dhe sharm", e cila "me muzikën dhe talentin e saj do të jetojë ndër gjenerata".

Tërmeti 7.2 shkallë godet një gadishull të Alaskës


ALASKA, 16 KORRIK - Një tërmet 7.2 shkallësh i Riherit e ka goditur një gadishull të Alaskës, ka thënë Vëzhguesi Gjeologjik i Shteteve të Bashkuara. Dridhjet janë regjistruar në orët e para të mëngjesit të së dielës, rreth 89 kilometra në jugperëndim të cytezës së vogël Sand Point, ka thënë agjencia.

Qendra Kombëtare për Paralajmërimet për Cunami në Alaska e ka zvogëluar ndërkohë një paralajmërim për cunami për jugun e Alaskës. "Për brigjet e tjera në ShBA dhe pjesën kanadeze të Paqësorit nuk ekziston rrezik për cunami", është thënë në njoftim. Alaska është goditur nga një

tërmet 9.2 shkallësh në mars të vitit 1964, njëherësh tërmeti më i fuqishëm që është regjistruar ndonjëherë në Amerikën Veriore.

Për pasojë ishte krijuar një cunami në Gadishullin e Alaskës dhe në Havai.

Të paktën 250 persona patën vdekur nga tërmeti dhe cunami.



Lirohet avokati Besnik Berisha

PRISHTINË, 16 KORRIK - Avokati Besnik Berisha është liruar të dielën pasi Gjykata Themelore në Ferizaj e ka refuzuar kërkesën për paraburgim. Lajmin e ka konfirmuar avokati i tij Naim Rudari. "Po, është liruar sot. Është refuzuar

kërkesa për paraburgim", konfirmoi ai.

Rudari tha se në aktvendimin e njërës nga gjykata i është caktuar masa ndalimi për t'u afuar vendit apo personave të caktuar".
Ndryshe, Prokuroria

Themelore në Ferizaj të premtën kishte kërkuar nga Gjykata Themelore eaktimin e masës së paraburgimit në afat prej 30 ditësh ndaj avokatit Besnik Berisha dhe gjashtë të pandehurve të tjerë: Nexhat Xhafa, Ismet Salihu, Jeton

Vuniqi, Fidan Zubaku, Refik Cakolli dhe Adonis Salihu. Ata dyshohen për "ushtrim ndikimi", "pengim i procedurës penale" dhe "dhënia e ndihmës kryesive pas kryerjes së veprave penale".



Nuk ka pritje të gjata në pikëkalimet kufitare

PRISHTINË, 16 KORRIK - Për shkak të situatës në veri, qeveria ditë më parë u kishte bërë thirrje bashkadhetarëve ta shmangin rrugën nëpër Serbi për të ardhur në Kosovë. Ndonëse në masë më të vogël, bashkadhetarët edhe këtë vit po e shfrytëzojnë rrugën nëpër Serbi. Megjithatë, shfrytëzimi më i pakët i kësaj rruge ka bërë që në pikëkalimin kufitar në Merdar të mos ketë pritje të gjata.


Bashkadhetari Safet Mehmetaj kaloi përmes pikëkalimit kufitar ndërmjet Kosovës dhe Serbisë në Merdar. Ai arriti në Kosovë pas shumë orëve rrugë nga Gjermania. Megjithatë, rruget e mërgimtarëve për të ardhur në Kosovë nuk është e lehtë. Endrit Bullatovi, që ka ardhur nga Gjermania, flet për

vështirësitë e kësaj rruge të gjatë. "Jo të gjithë i shfrytëzojnë makinat për të ardhur në Kosovë. Të tjerë zgjedhin të vijnë me autobus", ka thënë Bullatovi për RTK-në.

Driton Bajcinca, shofer i një autobusi që vinte nga Franca, thotë se udhëtimi ishte pa probleme, ndërsa tregon se sa shpesh ka linja të autobusit. Sipas Qendrës Kombëtare për Menaxhim Kufitar, pritjet për të hyrë dhe për të dalë nga Kosova, si në Merdar, ashtu edhe në pikëkalimet e tjera kufitare, nuk janë më të gjata se 5 minuta. Pas tensioneve në veri të vendit, qeveria u ka bërë thirrje bashkadhetarëve t'i shmangin pikëkalimet kufitare me Serbinë për të shmangur çfarëdo incidenti dhe t'i shfrytëzojnë rrugët e tjera alternative për udhëtim.



Vitin e kaluar mbi dy mijë çifte u shkurorëzuan, Prizreni është komuna me numrin më të madh të ndarjeve



EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 16 KORRIK - Gjatë vitit 2022 në Kosovë u shkurorëzuan më shumë se 2 mijë e 90 çifte. Kështu është bërë me dije nga raporti i Agjencisë së Statistikave të Kosovës për vitin e kaluar. Prizreni është komuna me numrin më të madh të ndarjeve, ku 209 çifte bashkëshortore zyrtarisht e ndryshuan statusin e tyre martesor.

Për dallim nga prizrenasit, në qytetin e Ranillugut e Zubin Potokut zero, sipas këtyre të dhënave.

638 çifte të cilët vendosën të shkurorëzohen kishin kaluar 5-9 vjet që martesën, ndërsa 135 çifte që kurorëzuan dashurinë e tyre me martesë kaluan bashkë 25 vjet e vendosën të shkurorëzohen pas më shumë se dy dekada.

Në këtë raport rezultojnë edhe 35 çifte që nuk festuan as përjetorin

e parë të martesës.

Sipas kësaj raporti të ASK-së, grupmoshat të cilat më së shumti u përbullen me këtë dukuri janë 30-34. Vitetmë gjatë vitit 2022, 431 çifte të kësaj moshë janë shkurorëzuar.

Ndërsa grupmosha nën 19 vjeç ka vetëm 9 raste. Në vazhdimësi, sociologët theksojnë se janë shumë faktorë socialë e ekonomikë të cilët bëjnë që një vendim i tillë të merret nga bashkëshortët.

Përfundon Universiteti Veror i Prishtinës

PRISHTINË, 16 KORRIK - Mbi 300 studentë dhe profesorë nga pesë kontinente të botës përfunduan rrugëtimin e tyre në edicionin e 22-të të Prishtina International Summer University. Për dallim nga edicionet paraprake, ky PISU u dallua për gjithëpërfshirje, ku nën moton "openUP", nën bulevardin "Xhorxh Bushi", për dy javë u mbajtën aktivitete të shumta akademike, kulturore dhe argëtuese.

Gjatë ceremonisë së mbylljes së PISU2023, rektori Qerim Qerimi adresoi një fjalim

frymëzues. "Pjesëmarrja juaj është dëshmi e shpirtit tonë të përbashkët njerëzor, një shpirt që nuk njih kufij dhe shikon djem si gjuhën më universale", u tha rektori 300 pjesëmarrësve të këtij edicioni të PISU-së. Ai shtoi se në vitet e ardhshme do të ofrojmë më shumë programe dhe kurse në anglisht, për të lehtësuar dhe nxitur mundësi për shkëmbim me më shumë studentë dhe studiues ndërkombëtarë. "Së bashku, mund të ndërtojmë një të ardhme ku dija na bashkon të gjithëve", ka thënë

rektori. Mbyllet e UVP-së e përshëndetën edhe prorektorja Arta Basha Jakupi, profesori gjerman Christian Mozcala, profesoresha Arbenita Hasani dhe studentët pjesëmarrës. UVP-ja, përveç 14 kurseve të organizuara, organizoi për studentët edhe punëtori, ekskursione, mbrëmje të filmit, mbrëmje tradicionale të ushqimit, këngës e vallezmimit, prezantime të njësive akademike, e plot aktivitete të tjera.





Kosova blen dronë “Bayraktar”

Ushtria jonë çdo ditë e më shumë po konsolidohet jo vetëm në aspektin e kadrove profesionale, por edhe me pajisje më moderne ushtarake. Dronët “Bajraktar TB-2”, të cilët u përruan nga ana e kryeministrit Albin Kurti, ministrit Armend Mehaj dhe komandantit të FSK-së, Bashkim Jashari, janë vetëm disa nga pajisjet e blera për ta forcuar ushtrinë tonë

EPOKA
RE **Mal QORRAJ**

PRISHTINË, 16 KORRIK - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka konfirmuar të dielën se Kosova ka blerë dronë “Bayraktar TB-2” nga Turqia. Në “Facebook”, Kurti është parë në afërsi të droneve, bashkë me ministrin e Mbrojtjes, Armend Mehaj dhe komandantin e Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), Bashkim Jashari. “Arsenalit të ushtrisë sonë i kemi shtuar edhe dronë Bayraktar TB-2 të cilët i kemi blerë si Qeveria nga Turqia. Në dy vjet qeverisjeje e kemi shtuar për mbi 80 % numrin e ushtarëve dhe mbi 100 % buxhetin për ushtrinë.

Kosova tash është edhe më e sigurt përveçse gjithnjë kënahe! Me komandantin e FSK-së gjeneralletënant Bashkim Jashari dhe ministrin e Mbrojtjes Armend Mehaj përgëzuaam oficerët që e kanë kryer trajnimin për përdorimin e droneve”, ka shkruar Kurti. Kurti nuk ka bërë me dije sa dronë janë blerë dhe as buxhet ka ndarë për ta. Dronët “Bajraktar TB-2”, të cilët u përruan nga ana e kryeministrit Kurti, ministrit Mehaj dhe gjeneral Jasharit, janë vetëm disa nga pajisjet e blera për ta forcuar ushtrinë tonë. Për vetëm dy vjet ngritja e numrit të ushtarëve është

mbi 80 %, e pajisjeve mbi 100 %. Kjo tregon që qeveria është e përkushtuar për përmbytjen e të gjitha standardeve për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në NATO si shteti i 33-të që do ta ofrojë kontributin brenda kësaj aleançe. Bayraktar (Flamurtar) është një dron relativisht i lirë, që për herë të parë ka fluturuar më 2014. Dronët e tillë, të llojit TB-2, përdoren nga ushtritë e disa shteteve dhe janë dërguar edhe në Ukrainë për t'i ndihmuar forcat e Kievit që të luftojnë kundër pushtimit rus. Pavarësisht se çmimi i një “Bayraktari TB-2” nuk është

bërë publik, më herët gjatë këtij viti ishte organizuar mbledhja e fondeve për të blerë dronë të tillë për Ukrainën dhe organizatorët e mbledhjes së këtyre fondeve kishin sugjeruar se 5 milionë euro janë të mjaftueshme për një dron. Ekspertët e sigurisë thonë se Bayraktari është një ndër dronët më të sofistikuar në botë dhe mund të operojë dhe të mbrojë në të gjithë territorin dhe kufijtë e Kosovës pa asnjë problem. Dronët e tillë, sipas ekspertëve të sigurisë, janë blerje e qëlluar për ushtrinë e Kosovës. “Lindje-perëndim, dhe veri-jug diku 170-180 kilometra hapësi”, këshuto që ky dron edhe fluturon në atë hapësië diku rreth 150 kilometra nga baza e saj se ku do të vendoset dhe sigurisht që nuk është e pamundur blera e këtyre droneve sepse iu përshatën kushteve dhe rrethit të Kosovës”, thotë Xhavit Sadriaj, ish-atashe i Sigurisë në Gjermani.

Ish-atashe i Sigurisë në Gjermani thotë se “Bayraktar TB-2” është një ndër dronët më të sofistikuar në botë. “Bart një ngarkesë mjaft të madhe me teknikë luftarake deri në 100-150 kilogramë, mund të pajiset edhe me raketa të mençura, që janë jashtëzakonisht precize në goditjen e tankeve ose edhe mjetëve të blinduara apo edhe bunkerëve”, shtoi ai. Forca e Sigurisë e Kosovës është në proces të transformimit në Ushtri. Kuvendi i Kosovës ka miratuar ligjet për këtë transformim në vitin 2018. Përgjegjësië e reja të FSK-së, mes të tjerash, kanë të bëjnë me ruajtjen e sovranitetit dhe integritetit territorial të Kosovës, si dhe të qytetarëve, pronave dhe interesave të vendit. Aktualisht FSK-ja ka rreth 2 500 pjesëtarë. Pas periudhës së tranzicionit, ky numër pritet të rritet mbi 7 500 dhe t'i përfshijë pjesëtarët aktivë dhe ata rezervistë.

Pse është kjo verë kaq e nxehtë?

NYU-JORK, 16 KORRIK - Është nxehtë. Shumë nxehtë. Jemi vetëm në javët e para të verës. Gati një e treta e amerikanëve - mbi 113 milionë njerëz - janë të parajlamëruar për rrezikun e motit të nxehtë, ka thënë Shërbimi Kombëtar për Motin në Shtetet e Bashkuara. Në ShBA temperaturat priten të shënojnë rekord të ri. Në El Paso dhe Teksas temperaturat kanë qenë mbi 37 gradë celsius për 27 ditë me radhë, duke e tejkaluar rekordin e vitit 1994.

Në Mbretëri të Bashkuar i nxehti i qershorit jo vetëm që ka thyer rekorde, por i ka tejkaluar bindshëm temperaturat paraprake. Qershori i këtij viti ka qenë 0.9 gradë celsius më i nxehtë sesa në të kaluarën. Situata e ngjashme raportohet edhe në Afrikën e Veriut në Lindje të Mesme dhe Azi. Prandaj nuk ka qenë befasi që qershori është shpallur viti më i nxehtë ndonjëherë në histori. Dhe ai i nxehtë nuk është zbehur. Tri ditë më të nxehta ndonjëherë sipas regjistruar javën e kaluar, sipas Shërbimit të Bashkimit Evropian për Klimë dhe Mot, Copernicus.

Temperatura mesatare në botë e ka prekur shifrën 16.89 gradë celsius më 3 korrik dhe e ka tejkaluar shifrën 17 gradë për herë të parë më 4 korrik, me një mesatare globale prej 17.04 gradë celsiusësh.



Më pas, më 5 korrik, është regjistruar temperatura 17.05 gradë celsius.

Këto temperatura përputhen me modelet klimatike që veçe janë parashikuar, ka thënë profesori Richard Betts, shkencëtar për klimën në Universitetin Exeter. "Ne nuk duhet të befasohejmë nga temperaturat e larta në botë", ka thënë ai.

"Ky është një përkujtesë, për të cilin kemi dëgjuar që një kohë të gjatë, dhe ne do të jemi dëshmitarë të motit edhe më të nxehtë, derisa të ndalojmë së lëshuari më shumë gazra serrë në atmosferë".

Kur e mendojmë sa nxehtë

është, ne mendojmë për temperaturën e ajrit, sepse atë e përjetojmë në përditshmëri. Mirëpo njësia më e madhe e të nxehtit që ruhet në sipërfaqe të Tokës nuk është në atmosferë, por në oqeanë.

Dhe ne kemi parë që temperaturat e oqeanëve kanë shënuar rekord në pranverë dhe verë të këtij viti. Shembull, në veri të Atlantikut, temperaturat aktualisht janë më të lartat ndonjëherë.

Administrata amerikane për Oqeanë dhe Atmosferë e ka vendosur këtë valë të të nxehtit në kategorinë e katërt. Një kategorizim i tillë përdoret rrallë jashtë vendeve

tropikale dhe konsiderohet "i nxehtë ekstrem".

Kësaj situatë është duke i kontribuar edhe fenomeni ElNino, që është aktiv në Paqësor.

El Nino është fenomen që ngroh ujërat në brigjet e jugut të Amerikës dhe më pas ato përhapen nëpër oqeanë.

Nëse uji i deteve është më i nxehtë sesa zakonisht, edhe ju do të përballeni me temperaturë të lartë të ajrit, ka thënë Tim Lendon, profesor për ndryshime klimatike në Universitetin Exeter.

Ai sqaron se pjesa më e madhe e të nxehtit është krijuar nga gazrat serrë dhe është ruajtur nëpër sipërfaqe

të oqeanëve.

Ndonëse ai i nxehti ka tendencë të zhytet brenda në oqeanë, fenomenet sikurse El Nino, mund ta nxjerrin atë sërish mbi sipërfaqe. "Kur ndodh diçka e tillë, sasi e madhe e të nxehtit del në atmosferë", ka thënë profesori Lendon.

Është e lehtë të mendojmë se ky mot tejet i nxehtë është i pazakonshëm, mirëpo e vërteta e dhimbshme është se ndryshimet klimatike nënkuptojnë se tani do të jetë normale që të përballeni me temperatura rekorde.

Gazrat serrë vazhdojnë të emetojnë çdo vit, madje me trend në rritje.

Sa më e nxehtë temperatura globale, aq më shumë rrezik për valë të të nxehtit, ka thënë Friederike Otto, eksperte për klimën në Institutin për Ndryshime Klimatike, Grantham. "Këto valë të të nxehtit jo vetëm që do të jenë më të shpeshta, por edhe më të nxehta dhe më gjata", ka thënë ajo.

Ekspertët veçe kanë parashikuar se El Nino mund ta bëjë vitin 2023 më të nxehtin ndonjëherë në botë.

Temperatura e Tokës është rritur për 1.1 gradë celsius prej njëjës së epokës industriale dhe temperaturat do të vazhdojnë të rriten, përveç nëse qeveritë në mbarë botën marrin hapa për t'i ndaluar emetimet e karbonit.

Lajçaky: Më vjen mirë që me Bislimin ramë dakord për hapat e parë drejt shtensionimit të situatës

PRISHTINË, 16 KORRIK - I dërguari special i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçaky, në një përmbledhje mbi diskutimet e kësaj jave mbi Ballkanin Perëndimor, ka thënë se ndihet mirë që me kryenegociatorin e Kosovës, Besnik Bislimi, kanë rënë dakord për hapat drejt shtensionimit të raporteve me Serbinë.

Në "Facebook", Lajçaku ka thënë se në takimin me Bislimin, fokus i bisedës ishte shtensionimi i situatës në veri të Kosovës. "Nga Dubrovniku udhëtova për në Bratislavë, ku mbajta diskutime të rëndësishme bilaterale me zëvendëskryeministrin e parë të Qeverisë së Kosovës dhe kryenegociatorin e Kosovës, Besnik Bislimi. Biseda jonë u përqendrua në shtensionimin e situatës në veri të Kosovës,

në përputhje me deklaratën e datës 3 qershor, dhe punën në drejtim të zbatimit të të gjitha marrëveshjeve të dialogut. Më vjen mirë që ramë dakord për hapat e parë drejt këtij qëllimi", ka thënë ai.

Pos kësaj, Lajçaku shkroi edhe për takimin me kryetarin e Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi. Ai ka theksuar se gjatë këtij takimi shkëmbyen mendime, teksa shton se është përgatitur për takimin e ardhshëm në Bruksel.

Për në Forumin vjetor në Dubrovnik, Lajçaku tha se u ofrua një mundësi e mirë për t'u angazhuar me aktorët kryesorë të Ballkanit Perëndimor, duke shtuar se janë bërë hapat e nevojshëm për shtensionim të raporteve në mes të Kosovës dhe Serbisë.



Mbi 700 pickime të rrigrave në Malishevë, tre persona janë dërguar në QKUK

Malishevë, 16 korrik - Edhe këtë vit në komunën e Malishevës janë shënuar mbi 700 pickime nga rriqrat, prej tyre tre persona janë dërguar në Klinikën Infektive në QKUK. Zyrtarë nga kjo komunë thonë se ata kanë bërë spjekatjet dhe repelimin e kafshëve, por edhe kanë mbajtur ligëratë në shkollat e kësaj komunë si të mbrohjen nga pickimet e rrigrave. Komuna e Malishevës njihet si vatër endemike e rrigrave, ku nga paslufta, si pasojë e etheve hemorragjike Krime Kongo, kanë vdekur 18 persona. E kjo vazhdon të jetë ende sfidë për këtë komunë, ndonëse nga vit

2014, përveç pickimeve, nuk ka asnjë rast vdekjeje. Drejtori i Shëndetësisë nga kjo komunë, Hajdin Berisha, për Radio Kosovën thotë se, përkundër përgatitjeve dhe masave parandaluese që janë ndërmarë, ka një numër të konsiderueshëm të pickimeve. "Aktualisht i kemi 752 raste të pickimeve. 3 raste i kemi dërguar në Klinikën Infektive. Krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar, ka rënie. Jemi në muajin korrik dhe mund të shtohet numri i pickimeve", tha ai. Komuna e Malishevës për parandalimin e përhapjes së etheve hemorragjike, përveç



spjekatjes, ka organizuar edhe fushatë për informimin e publikut. Megjithatë, drejtori Berisha thotë se shqetësim mbetet repelimin i kafshëve që duhet të bëhet nga Agjencia e Ushqimit dhe Veterinës. Berisha sqaron se për ta parandaluar shumimin e rrigrave kanë ndërmarë aksione për pasttrimin e deponive të mbeturinave. "Kemi filluar vit pas viti eliminimin e deponive, pastaj rekomandimet dhe këshillat dhënë fermerëve. Kemi shkuar te familjarët që t'u tregojmë se si mbahet oborri, pastaj si duhet të përkujdesen për kafshët", tha ai.

Familjarët e personave me aftësi të kufizuara thonë se asistencë financiare që marrin është e pamjaftueshme

PRISHTINË, 16 KORRIK – Ramush Gashi është detyruar ta lë punën për t'u kujdesur për vajzën e tij me aftësi të kufizuara. Paga e majore që merr është e pamjaftueshme edhe për shërbimet e detyrueshme mjekësore e lëre më për një kujdestare. Që asistencë financiare është e pamjaftueshme për personat me aftësi të kufizuara thonë edhe në Shoqatën "Handikos" në Prishtinë. Sipas tyre, aktualisht për një kujdestar ofrohen 150 euro, që është vlerë shumë e vogël. Gashi, që thotë se aktualisht merr 375 euro në muaj asistencë, thekson se është e pamjaftueshme për t'i mbuluar shpenzimet për vajzën e tij e lërë për të paguar edhe një kujdestare. Prandaj, është detyruar ta ndërpresë punën që t'i gjendet aftëri vajzës. Gashi tregon për "KosovaPress" se vetëm një seancë ushtrimi, për të cilën ka nevojë vajza e tij, kushton 20 euro, pa llogaritur nevojat e tjera. "Shtesat që i marrim për fëmijë janë të pamjaftueshme, nuk dalin, sepse vajzës duhet t'i bëhen ushtrimet që i ka e që i kushton

20 euro një ushtrim në ditë. Komplet muajin e kalon gjysmën e pagesës si dhe shumë sende të tjera që u nevojiten fëmijëve me aftësi të kufizuara. Nuk dalin edhe për sende të tjera, për barna dhe nevoja të tjera", thotë Gashi. Edhe Faruk Kukaj, person me aftësi të kufizuara, është i pakënaqur me pagesën që merr nga shteti. Ai thotë se me këtë lartësi pagese nuk mund të gjejsh as kujdes për të cilin kanë nevojë edhe 24 orë. Drejtori i Shoqatës "Handikos", Afrim Maliqi, konfirmim se pagesat që marrin nga shteti nuk i plotësojnë nevojat e tyre. Ai thotë se personat me aftësi të kufizuara janë detyruar t'i mbulojnë vetë pothuajse shumicën e shpenzimeve që i kanë, pasi shteti nuk mbulon për ta asgjë. "Kemi bërë përpjekje për disa skema financiare të cilat me to personat me aftësi të kufizuara duhet t'i blejnë të gjitha shërbimet rehabilituese, mjekimetet e përgjithshme, madje duhet të paguajnë edhe kujdestar, çili është i pamjaftueshëm. Personat me aftësi të kufizuara janë të liruar vetëm nga kontrollat bazë



mjekësore, ndërsa të gjitha shpenzimet e tjera duhet t'i blejnë e që janë të përditshme.

Gjendja e tyre ka nevojë për medikamente të përditshme", shprehet Maliqi.

Maliqi thotë se personat me aftësi të kufizuara i dalin vetëm falë familjarëve.

Faza testuese në trafik në Pejë vazhdon edhe për një javë



PRISHTINË, 16 KORRIK – Faza testuese e rrugëve të Pejës për ndryshimin e qarkullimit në trafik në drejtimin njëkahësh në disa rrugë lokale në qytet, siç ka qenë e paralajmëruar, është dashur të mbarojë këtë të diel. Mirëpo komuna e Pejës, nëpërmjet drejtorit për Shërbime Publike, Agron Nikqi, ka konfirmuar për "RADIO 1" se e njëjta vazhdon edhe për një javë. "Ju konfirmoj se është marrë

vendim që faza testuese që është në fuqi të vazhdojë edhe për një javë, respektivisht deri më 23 korrik", tha Nikqi. Lidhur me këtë ka folur edhe Nue Nikolla, komandant i Stacionit Policor në Pejë. Nikolla ka konfirmuar se janë në zbatim të vendimeve të strukturave komunale. Po ashtu, ai ka kërkuar bashkëpunim me qytetarë në këtë fazë testi. "Policia

është në zbatim të vendimeve të institucioneve komunale. Sapo na ka aritur vendimi verbal nga institucioni i komunës së Pejës për vazhdim edhe një javë të testimit", tha Nikolla. Në vendimin paraprak komunale e Pejës kishte njoftuar se ky plan testimi ka për qëllim realizimin e qarkullimit sa më të lehtë dhe evitimin e ngarkesave në trafikun urban nga mjedet motorike.

Kosova as sivjet nuk pritet ta sigurojë bukën

Prishtinë, 16 korrik - Në disa vende të Kosovës ka nisur fushata e korrje-shirjeve të grurit, por vendi edhe sivjet nuk pritet ta sigurojë bukën e motmotit. Përkundër punës së përkushtuar të bujqve nëpër arat e tyre, pranvera e ftohtë ka ulur prishmëritë për prodhim të bollshëm të grurit. Rreth 40 për qind rendimentit me grurë pritet të jetë më i ulët si pasojë kushteve jo të përshtatshme atmosferike. Për këtë konsiderohet se edhe në këtë vit Kosova do të jetë e varur

nga importi i grurit. Në anën tjetër, shumë toka po mbesin djerrina e për to po kritikohen institucionet. Dujtjii po tërhiqen nga prodhimtaria meqë nuk kanë mundësi ekonomike t'i përballojnë humbjet. Profesori i bujqësisë, Imer Rusinovi, thotë se këtë vit ka një trend rritës të sipërfaqeve të grurit por, sipas tij, prodhimi nuk do të jetë siç është planifikuar. "Për dallim nga vitet e kaluara, sivjet është një trend më i madh i sipërfaqeve

të mbjella me grurë dhe planifikimet, prishmëritë kanë qenë më të mëdha në raport me vitet e kaluara, por që pranvera ishte e ftohtë, kishte reshje të vazhdueshme, atakuan shumë ngastrat kultivuese patogjenet dhe sëmundjet dëmtes, me këtë edhe prodhimi nuk do të jetë ai që ka qenë i planifikuar. Edhe këtë vit do të varemi nga importi i grurit siç e kemi pasur traditë edhe viteve të kaluara", ka thënë Rusinovi, raporton ksp.



Kurti: Përfitimet për veteranët nuk nënkuptojnë pagë

Prishtinë, 16 korrik - Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti, ka thënë se mbështet dhënien e sa më shumë përfitimëve për veteranët e luftës së fundit në Kosovë, por që përfitimet, sipas tij, nuk janë pagë. "Paga është për punë, ndërkaq përfitimet janë mirënjohje e shoqërisë, e cila i jepet veteranit të luftës për luftën çlirimtare, fitimtare, e cila është në burim të shtetësisë, pavarësisë dhe lirisë sonë".

Ai i ka bërë këto deklarata para se të mbahet protesta në Prishtinë kundër Ligjit për Paga Minimale të miratuar në lexim të dytë në Kuvendin e Kosovës më 13 korrik.

Ligji parashkë rritjen e pagës minimale në 264 euro bruto, apo 250 euro neto, nga 130-170 sa është aktualisht.

Protesta është thirrur nga Organizata e Veteranëve të Luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (OVL e UÇK-së), e cila është shprehur e pakënaqur pse përfitimet për veteranët nuk janë lidhur me pagën minimale në ligjin e ri.

Deri më 2017 pensioni i veteranëve nuk ka mundur të jetë më pak se paga minimale në Kosovë, përkatësisht 170 euro. Kjo, njëherësh, vazhdon të jetë shuma që marrin ata.

Kurti ka thënë se do të angazhohet në ligj të ri për veteranët, por që fillimisht faktet duhet të jenë të sakta. "Unë besoj se në luftën çlirimtare kanë marrë pjesë edhe më shumë se 60 mijë



pjesëmarrës, mirëpo ka një lloj trefshimi të numrit të veteranëve. Prandaj është e domosdoshme që gjërat t'i quajmë me emra adekuatë. Veteranët, sipas komandantëve të UÇK-së, janë rreth 20 mijë, ndërkaq nëse i bashkëngjisim edhe pjesëmarrësit, atëherë do të bëhen edhe më shumë se 60 mijë. Andaj unë jam që të kemi falënderimin e mirënjohjen si shoqëri për të gjithë, mirëpo nuk mund ta deformojmë

luftën çlirimtare të UÇK-së", ka deklaruar Kurti. Kurti ka thënë se shpreson që do të punojë me shoqatë e dala nga lufta për ta rregulluar këtë çështje dhe që të krijohet mundësia që veteranët edhe të punojnë. "Sepse një numër i madh i veteranëve të UÇK-së nuk janë për pension, nuk janë për pensionim, sepse janë të rinj. Shumë prej tyre nuk i kanë as 50 vjet", ka thënë Kurti. Nga Instituti i Kosovës për

Drejteshi dhe nga Organizata për Demokraci, Anti-korruption dhe Dinjitet "Cohu", kanë vlerësuar se pa përfunduar procesi gjyqësor lidhur në rastin "Veteranët", pastrimi i listës së veteranëve nuk mund të bëhet. Gjykata e Apelit, më 26 prill të vitit 2022, ka kthyer në rëgjimkin rastin e njohur si "Veteranët". Në akuzën e ngritur nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës, e cila ishte konfirmuar nga Gjykata

Themelore në Prishtinë, më 19 qershor të vitit 2019, është ngritur dyshimi se për 19 500 persona është dhënë statusi i veteranit në mënyrë të paligjshme.

Aktualisht, sipas të dhënave zyrtare nga Qeveria e Kosovës, statusin e veteranit luftëtar e kanë 53 188 persona, kurse sipas të dhënave të Agjencisë së Statistikave të Kosovës, 37 006 janë përfutur nga skema për veteranët e luftës.

Anulohen rreth 1 000 futurime në Itali si pasojë e grevës

ROMË, 16 KORRIK - Grewa kombëtare e punëtorëve të trafikut ajror në Itali, që është mbajtur të shtunën, ka rezultuar me anulimin të gati 1 000 futurimeve, ka raportuar agjencia e lajmeve ANSA. Sipas sindikatave, të cilat kanë bërë thirrje për grevë, gati të

gjithë punëtorët që është parashikuar të grevojnë janë bashkëngjitur në aksion. Ata janë duke kërkuar kontratë të re kolektive gjashtë vjet pas skadimit të kontratës paraprake. Pjesëmarrës ka qenë edhe stafi tokësor, që është përgjegjës për shërbime të

regjistrimit të udhëtarëve. Vetëm në aeroportet më të mëdha të Italisë: në Romë, Milano, Napoli dhe Venecia, qindra futurime janë anuluar, duke dekur mbi 250 000 pasagjerë. Asociacioni për Mbrojtje të Konsumatorëve Codacons

beson se dëmet e shkaktuara nga anulimet e futurimeve janë në vlerë të miliona eurove. Përveç stafit tokësor, edhe pilotët e kompanisë Malta Air, që realizojnë fluturimet e kompanisë Ryanair në Itali, dhe pilotët të kompanisë ajrore Vueling, kanë marrë pjesë në

grevë. Kjo është hera e dytë brenda një jave në Itali që është mbajtur grevë e shkallës së tillë. Grevat janë duke e goditur këtë shtet të njohur për turistikë - në pikun e sezonit dhe tekta Evropa dhe pjesët e tjera të botës po përballen me temperatura shumë të larta.

Teoria e kaosit: Rrahja e krahëve të një fluturë ndryshon gjithçka



Teoria e kaosit është një ligj i shpallur nga James Yorke dhe që na kujton një fakt thelbësor: bota nuk ndjek një model të saktë dhe të parashikueshëm; duam apo s'duam, në jetën tonë ekzistojnë edhe kaosi, kjo hapësirë e vogël që i është lënë rastësisë, ku është thajusje e pamundur të parashikosh efektin e ngjarjeve të caktuara. Është mjaft e zakonshme të lidhet teoria e kaosit me degët e saj mëmë: matematika dhe fizika. Megjithatë, shpesh harrojmë se këto shkencë kanë një implikim të drejtpërdrejtë në jetën tonë të përditshme, në të vërtetë ka shumë pak sektore që kanë ndikim të njëjtë në sjelljen dhe njohuritë tona.

Vetë James Yorke e përmbledh rëndësinë e teorisë së tij në një fjali të thjeshtë: njeriu duhet të jetë i përgatitur për të ndryshuar planet në çdo moment.

Secili prej nesh ka një shkallë të caktuar tolerancë ndaj pasigurisë. Duke u nisur nga një prag i caktuar, truri ynë kalon në "modalitet alarmi" ndaj asaj që mund të ndodhë. Ne preferojmë stabilitetin, duke ditur se dy plus dy janë katër dhe se ajo që na rrethon dhe kemi sot do të jetë aty edhe në të nesërmen tonë. E gjithë kjo na ofron një eksulibër emocional faqe të cilat jemi në gjendje të shijojmë jetën, duke mbajtur gjithçka

nën kontroll. Megjithatë, teoria e kaosit mbron një provë. Jeta dhe rrjedha e saj nuk korrespondojnë me ecurinë ritmike dhe të përsosur të një ore. Të parashikueshmet dhe të pakontrollueshmet gjenden gjithmonë brenda dhe rreth nesh.

Është ajo shpata e Damokleut që mund të na godasë në çdo moment. Është ajo fluturë që sot fluturon mbi Shtetet e Bashkuara dhe më vonë mbërrin në Evropë në formën e një krize ekonomike. Është ai topi i bardhë që ne godim në bilardo dhe që godet topat e tjerë duke i bërë ata të lëvizin, ndonjëherë në drejtime të papritura...

Teoria e Kaosit: Natyra është e paparashikueshme

Teoria e kaosit na thotë se rezultatit i një ngjarjeje varet nga disa variabla: ato, sjellja e të cilëve nuk është gjithmonë e parashikueshme me saktësi totale. Gjithmonë ka një kufi për gabim, një hapësirë për kaos, një valëvajtje që ndryshon gjithçka në momentin e fundit. Sepse, ndonjëherë, një ndryshim i vogël gjeneron një efekt të përmasave të mëdha. Ka nga ata që argumentojnë se teoria e kaosit është një nga fushat më të mrekullueshme

të matematikës moderne. Ajo shkencë përpiqet të parashikojë sjelljen e sistemeve në thelb të paparashikueshme.

Në mund të imagjinojmë reagimet ndaj kësaj teorie pasi, deri vonë qëllimi i botës shkencore ishte të eliminonte variablin e pasigurisë në mënyrë që të ishte në gjendje të përkruante me saktësi sjelljen e pothuajse çdo gjëje. Megjithatë, në ditët e sotme ne e pranojmë këtë diferencë në të cilën rastësia dhe e paparashikueshmja, në një moment të caktuar, mund të ndryshojnë gjithçka. Kjo, në fakt, u zbulua nga meteorologu dhe matematikani Edward Lorenz në vitin 1961, kur ai u përpoq të krijonte një sistem kompjuterik për të parashikuar motin. Papritur ai kuptoi se, për shkak të një gabimi të përafëritim në numra, i gjithë sistemi kishte filluar të shfaqte sjellje qarësish të paparashikueshme. Më vonë kjo përvijë u përdor për të formuluar efektin e famshëm të fluturës.

Kaosi është vazhdimisht mes nesh

Fenomenet kaotike janë të shumta jo vetëm në natyrë, por edhe në biologji. Nuk ka asnjë zonë të lirë nga kjo sjellje e paparashikueshme. Dukuri kaotike ndodhin çdo

ditë pothuajse pa e kuptuar: në ekonomi, termodinamikë, astronomi dhe madje edhe psikologji.

Tani e dimë se çdo shqetësim i vogël në trurin tonë (siç është një ndryshim në një neurotransmetues) mund të rezultojë në ndryshime shumë dramatike në sjellje. Teoria e kaosit pranohet edhe në psikiatri. Ndonjëherë kur pacientit i jepet një ilaç, ekziston një shans i vogël që efekti i vërejtur të jetë i kundërt nga ai i pritur, "Lëvizja e krahëve të një fluturë mund të shkaktojë një uragun në anën tjetër të botës."

– Proverb kinez –

Si të zbatohet teoria e kaosit në jetën e përditshme?

Në jetën tonë të përditshme të gjithë duhet të shmangim kaosin. Vetëm kështu ndihemi të sigurt, vetëm kështu mund të ndërtojmë një jetë ku e paparashikueshmja do të na lejojë të largohemi nga shtëpia pa frikë dhe të jemi në gjendje të shikojmë të ardhmen me besim. Siç na shpjegon James Yorke, babai i kësaj teorie, gjëja më e mirë për të bërë është të jesh gat për të ndryshuar planet në çdo moment.

Ky parim është i lidhur ngushtë me një teori tjetër aktuale. Po flasim për teorinë e mjellmës së zezë, të formuluar nga eseisti, ekonomisti dhe matematikani Nassim Nicholas Taleb.

Në librin e tij interesant, i cili mban të njëjtin emër me teorinë, ai na kujton se shumica prej nesh i nënshtrohen një botëkuptimi ku gjithçka, në pamje të parë, duket e parashikueshme. Megjithatë, në një moment të caktuar lind e papritura, e paparashikueshmja, kaotikja... ajo erë që nuk e prisnim. Një ngjarje e paparashikueshme që jemi të detyruar ta pranojmë dhe ta racionalizojmë.

Megjithatë, duhet thënë se në vend që të veprojmë vetëm kur ky kaos shpalletet para syve tanë, duhet të jemi të përgatitur. James Yorke na kujton se njerëzit që arrijnë sukses dhe lumtur janë ata që kanë gjithmonë një plan "B" në dorë.

Le të përpiqemi të zhvillojmë një mentalitet fleksibël dhe një qasje ku nuk reagojmë vetëm ndaj ngjarjeve. Le t'i përqafojmë me kuriozitet dhe praninë, sepse shumë herë është në kaos që lindin mundësitë. Në fund, të jesh i përgatitur për të papriturat do të thotë të kalosh nëpër të njëjtat ulje dhe ngritje të jetës. / bota.al

Kuron bimët, organizon fundjava, shkruan poezi: Njihuni me Inteligjencën Artificiale



Të ashtuquajturve "boomers", brezit të të lindurve midis viteve 1946 dhe 1970 [gjatë të ashtuquajturit "baby boom" të shekullit të kaluar], ardhja e internetit dhe teknologjisë i kanë krijuar mjaft probleme, megjithëse, në shumë aspekte, e bëjnë jetën më të lehtë. Zhvillimi i Inteligjencës Artificiale shënon padyshim një përshpejtim në këtë rrugë. Inteligjenca Artificiale ka aftësinë të mësojë dhe të rrisë njohuritë e saj nëpërmjet mekanizmave, të quajtur algoritme, të cilat funksionojnë pak a shumë si ato të trurit të njeriut. Rezultati mund të jetë krejtësisht befasisës. Dhe nuk po flasim për gjëra komplekse apo gjëra larg përditshmërisë sonë, por fusha jashtëzakonisht praktike, për të përmirësuar produktivitetin, efikasitetin dhe madje edhe kohën e lirë. Ja disa shembuj praktikë.

Chatbots dhe asistentë virtualë

Ngrini dorën nëse nuk e keni gjetur kurrë veten në situatën e pakëndshme kur keni një problem me telefonin dhe, duke kërkuar ndihmë tek shërbimi ndaj klientit, duhet të ndërprejoni me një përgjigje automatike, të ashtuquajturin

"Chatbot". Në letër, këto programe kompjuterike të sofistikuar janë krijuar për të bashkëpunuar me përdoruesit përmes një bisede.

Në praktikë ato përfaqësojnë arsyen për marrjen e vendimit për të ndryshuar kompaninë telefonike. Duke përdorur teknologji moderne të Inteligjencës Artificiale si ChatGPT, përkundrazi, këto Chatbot mund të gjenorëjnë më në fund përgjigje automatike natyrale dhe të thelluara, duke e bërë komunikimin më të kënaqshëm dhe të këndshëm (po aq të dobishëm). E njëjta gjë vlen edhe për asistentët virtualë që tani popullojnë shtëpitë dhe telefonat celularë. Falë integritimit me ChatGPT, ndërveprimi me këto sisteme bëhet gjithashtu më i menjëhershëm dhe brenda mundësive të kujtdo.

Mes studimit dhe punës

Falë aftësisë për të gjeneruar tekste në pak minuta, praktikisht për çdo temë të imagjinueshme, një inteligjencë artificiale si ChatGPT mund të kënaqë shumë mësimet, për të përgatitur mësim, por mbi të gjitha studentët që, nëpërmjet saj, mund të marrin

përmbledhje të fragmenteve, skica për raporte dhe madje teza të plota të gatshme për përdorim. Nuk është rastësi që bota e arsimit i kushton vëmendje të veçantë kësaj teknologjie të re. E njëjta gjë vlen edhe për redaktorët, faqet e internetit ose letrat e shpirtura dhe autorët në përgjithësi si dhe autorët e kopjimit, pra ata profesionalistë që janë të specializuar në krijimin e teksteve të shkurtra të një natyre komerciale, siç janë përshkrimet e produkteve për dyqanet online.

Në të gjitha gjuhët për të gjitha rrjetet sociale, ChatGPT mund të ndihmojë gjithashtu punën e përkthyesve, duke u programuar për të ndërvepruar në gjuhë të ndryshme. Dallimi me shërbimet e përkthimit me makinë të përdorura deri tani është i madh. Shërbimet e vjetra kufizoheshin në përkthimin "fjalë për fjalë" të tekstit të futur, pa marrë parasysh kuptimin apo kontekstin. Por, kur dorëzoni një pasazh për t'u përkthyer në ChatGPT, dhe në përgjithësi në një mjet Inteligjenca Artificiale, sistemi është në gjendje të nxjerrë kuptimin e tij, deri në nuancat më të vogla, duke të ofruar një përkthim që nuk është vetëm i saktë, por edhe i rrjedhshëm

dhe i natyrshëm: ndonjëherë është edhe e vështirë ta dallos atë nga ajo që ofron një përkthyes profesionist. Kjo do të thotë, për shembull, që ata që krijojnë përmbajtje për rrjetet sociale edhe nëse nuk zotërojnë anglisht, do të mund të ofrojnë lehtësisht përmbajtje të targetuar për një audiencë të paarrtshme deri tani.


Në udhëtim me Inteligjencën Artificiale

Shfletimi në internet për të organizuar një pushim të shkurtrë bëhet edhe më i lehtë dhe më i shpejtë falë ChatGPT dhe Inteligjencës Artificiale. Për shembull, mjafton të kërkojë tre destinacionet më të mira për një fundjavë me familjen, duke filluar nga një vend i saktë, për të marrë brenda pak gaste një përgjigje të saktë si për destinacionet e mundshme, ashtu edhe për mënyrën e arritjes. ChatGPT është gjithashtu në gjendje të ndihmojë në identifikimin e vendeve më interesante artistike dhe natyrale. Pasi të jetë zgjedhur vendi dhe të jenë përcaktuar ndalesat, ChatGPT është gjithashtu në gjendje të sugjerojë disa gatime tipike të vendit ku po shkon.

Nga biznesi në dietë

Siç u përmend më lart, ChatGPT dhe IA po bëjnë bujë tani. Për ta verifikuar këtë, mjafton të bëni një kërkim të shpejtë në internet për të zbuluar se shumë përdorues, vecanërisht ata më të rinjtë, kanë filluar ta përdorin këtë mjet për të kryer detyra nga më të ndryshmet. Shumë, duhet thënë, janë përqendruar në atë se si të fitojnë falë ChatGPT, ndonjëherë duke krijuar aktivitete të reja krijuese. Por ka edhe nga ata që kanë përdorur IA për të marrë receta dhe këshilla të reja në kuzhinë ose për të përmirësuar kufeshin e bimëve të dhomës së tyre të ndenjes. Pastaj ka nga ata që kanë zbuluar (kush e di se si) se algoritmi ChatGPT ka gjithashtu aftësinë për të kompozuar vargje dhe kanë shfrytëzuar Inteligjencën Artificiale për t'i bërë ata të shkruajnë poema dashurie ose tekste për këngë.

Ka edhe nga ata që kanë vendosur të kursejnë para për trajnerë personalë dhe dietologë, duke kërkuar këshilla nga ChatGPT për t'i rutinë të përditshme ushtrimesh dhe dietën e duhur për të hequr qafe kilogramet e tepërt. E pashmangshme për ata që kalojnë orë të tëra para kompjuterit duke biseduar me një Inteligjencë Artificiale moderne. / [bota.al](#)



Kosova e fiton ndeshjen e fundit në Evropian

PRISHTINE, 16 KORRIK - Përfaqësuesja e Kosovës në hendboll e ka mbyllur me fitore Kampionatin Evropian U19 për hendbollistë. Të dielën në ndeshje për vend

të shtatë, Kosova e mposhti Letoninë. Vajzat tona kanë dominuar që nga fillimi dhe kanë fituar me rezultat 36:31. Kombëtarja jonë ka mbajtur epërsi solide gjatë

tërë ndeshjes dhe ka festuar në fund. Mirjeta Dinolli u shpall më e mira. Ajo shënoi nëntë gola nga nëntë tentime. Shtatë gola i shënoi Angelina Krasniqi. Pesë

gola i kishte Elsa Kongjeli. Kosova U19 e mbylli Evropianin me dy fitore e katër humbje. Letonia i humbi të gjitha pesë ndeshjet



Kosova e fiton edhe miqësoren e dytë ndaj Lihtenshtajnit

PRISHTINE, 16 KORRIK - Albulena Fejza, Gresa Berisha, Blerta Smaili, Leonora Ejupi, Loreta Lulaj, Blerta Shala, Viola Abdullu, Modesta Uka, Egzona Zeka dhe Jehona Shala ishin titullare, derisa në pjesën e dytë u aktivizuan shumica e futbollistëve tjerë. Edhe në këtë ndeshjen Kosova e dominoi lojën që nga fillimi, por vapa e madhe ndikoi në paraqitjen e të dyja ekipëve. Përkundrazi disa rasteve të krijuara kjo pjesëllojë u mbyl pa gola. Në pjesën e dytë trajnerja Andersen

bëri disa vendësimë, të cilat sollën freski në lojë por edhe gola. Ishte minuta e 75-të kur Donjeta Hallaj shënoi me një goditje të saktë nga zona për zbllokimin e shifrave, derisa pesë minuta më vonë Rezona Ramadani shënoi për 2-0, që në fund ishte edhe rezultati përfundimtar i kësaj ndeshjeje. Këto dy miqësore i kanë shërbyer përgjithësisë Andersen për ndeshjet e edicionit të parë të Ligës së Komebe që nis në shtator.

bëri disa vendësimë, të cilat sollën freski në lojë por edhe gola. Ishte minuta e 75-të kur Donjeta Hallaj shënoi me një goditje të saktë nga zona për zbllokimin e shifrave, derisa pesë minuta më vonë Rezona Ramadani shënoi për 2-0, që në fund ishte edhe rezultati përfundimtar i kësaj ndeshjeje. Këto dy miqësore i kanë shërbyer përgjithësisë Andersen për ndeshjet e edicionit të parë të Ligës së Komebe që nis në shtator.



Gjeraj: Ballkani është një 'minikombëtare' e Kosovës



